



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 964 prot.

Pukë, më 10.05.2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 1 Datë 10.05.2022

**PËR KRIJIMIN , ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR RINOR**

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të Neni 54, pika “m” të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 3, pika 1; neni 14, pika 1; neni 15, pika 1/a dhe 2; neni 16, pika 1; neni 17; neni 18; neni 19; neni 20, pika “ç”, në vendimin nr. 969 , datë 02.12.2020 “ Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit te tij” ligjit nr.75 , datë 04.11.2019 “ Për rininë” kreu II , neni 7 dhe neni 10 , me Propozim të Kryetarit të Bashkisë

**VENDOSI :**

1. Të ngrihet , organizohet dhe të funksionojë Këshilli Vendor Rinor , organ këshillimor , pranë Bashkisë Pukë me qëllim të përfshirjes, pjesmarrjes dhe mbështetjes të të rinjve në kompetenca të institucioneve në nivel vendor.
2. Ngritja e Keshillit Vendor Rinor do të përbëhet nga përfaqësues të përzgjedhur sipas kritereve dhe procedurave të shënuara në VKM-në nr.969 , datë 02.12.2020 “ Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit te tij”:
  - a) Kryetari i Bashkisë
  - b) Përfaqësues i Bashkisë
  - c) Përfaqësues të organizatave rinore OJF.
  - d) Përfaqësues të këshillave studentore .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”.

**Drejtor DMBNJ**  
**Emirjona Pergjegjaj**

**Jurist**  
**Aida Sinani**

**KRYETARI**  
**Gjon GJONAJ**

Ne mungese dhe me urdhor

**Zv.kryetari**  
**Ershela Gjoni**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 964/1 prot.

Pukë, më 10 . 09 . 2022

## Relacion

### PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR RINOR

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”, në vendimin nr. 969 , datë 02.12.2020 “ Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij” ; ligjit nr.75 , datë 04.11.2019 “ Për rininë” , kreu II , neni 7 dhe neni 10 , me qëllim që të krijohet , organizohet dhe të funksionojë Këshilli Rinor Vendor . Kështu Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin , ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të miratohet krijimi , organizimi dhe funksionimi i Këshillit Vendor Rinor me qëllim aktivizimin, pjesmarrjen , mbështetjen e të rinjve , promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në veprimtaritë rinore.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

Të ngrihet , organizohet dhe të funksionojë Këshilli Vendor Rinor , organ këshillimor, me qëllim të përfshirjes , pjesmarrjes dhe mbështetjes të të rinjve në kompetenca të institucioneve në nivel vendor.

Si një organ këshillimor **me objektiva të qartë si :**

- Mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyre gjithëpërfshirëse .
- Krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin , pjesmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve.
- Përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel vendor.
- Si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushen e rinisë.

**Qëllimi kryesor** i krijimit të këtij këshilli është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë , si dhe financimin e veprimtarive rinore , në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të vecantë.

**Kompetencat e Këshillit Vendor të rinisë janë:**

- Këshillon njesite e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë.
- Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor.
- Propozon përmirësime të politikave vendore rinore si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë.
- Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

**Ngritja e Keshillit Vendor Rinor** do të përbëhet nga përfaqësues të përzgjedhur sipas kritereve dhe procedurave të shënuara në VKM-në nr.969 , datë 02.12.2020 “ Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij”:

- a) Kryetari i Bashkisë
- b) Përfaqësues i Bashkisë
- c) Përfaqësues të organizatave rinore OJF.
- d) Përfaqësues të këshillave studentore .

1. Për të gjitha qëllimet e lartpërmendura propozohet të ngrihet pranë Bashkisë Pukë , Këshilli Vendor Rinor , si organ këshillimor.

**Drejtore Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore  
Emirjona Pergjegjaj**

